

raport

MONITORIMI I SHTYPIT TË SHKRUAR PËR TRAFIKIMIN E GRAVE DHE VAJZAVE

1 shkurt - 31 dhjetor
2014



Ky projekt është financuar
nga Bashkimi Europian



MINISTRIA E PUNËVE
TË BRENDRIME



United Nations Entity for Gender Equality
and the Empowerment of Women

Ky botim është realizuar në kuadër të projektit “EIDHR/2013/335–757: Parandalimi dhe adresimi i dhunës ndaj grave e vajzave në Shqipëri”, i cili zbatohet nga Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Shqipëri dhe mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e UN Women Shqipëri dhe Bashkimi Evropian.

Ekipi i Autorëve:

Konsulente Kombëtare:

MA. Valbona Sulçe Kolgeci,
Eksperte në Media dhe Çështjet Gjinore

Ndihmuan në Studim:

MA. Erisa Çela,
Koordinatorë Kombëtare e Programit Fuqizimi Ekonomik i Gruas

MA. Irena Shtraza,
Koordinatorë Projekti, UN Women Shqipëri

UN WOMEN

UN Women është organizata e Kombeve të Bashkuara kushtuar barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave. Përkrahëse botërore për gratë dhe vajzat, UN Women është themeluar për të përshpejtuar progresin dhe përmbushjen e të drejtave të grave në të gjithë botën.

UN Women vepron nën bindjen themelore se gratë dhe vajzat kudo në botë kanë të drejtën e një jete pa diskriminim, dhunë dhe varfëri dhe se barazia gjinore është në qendër të arritjes së zhvillimit.

Barazia gjinore nuk është vetëm një nga të drejtat themelore të njeriut, por duke fuqizuar gratë në vendet në zhvillim, nxit produktivitetin dhe sjell rritje ekonomike.

TABELA e LËNDËS

SHKURTIME	5
PARATHËNIE	6
HYRJE	8
KAPITULLI I: KONTEKSTI	10
1.1 Kuadri ligjor për mediat	11
1.2 Qëllimi i monitorimit	12
KAPITULLI II: METODOLOGJIA	14
2.1 Kampioni	14
2.2 Kriteret dhe kufizimet	15
KAPITULLI III: GJETJET E MONITORIMIT	18
3.1 Karakteristikat kryesore të raportimit të trafikimit të grave dhe vajzave në shtypin shqiptar	18
3.2 Trafikimi i grave dhe vajzave- një pamje e përgjithshme	19
3.2.1 Llojet e trafikimit të pasqyruar në shtyp	23
3.3 Raportim, informim apo ndërgjegjësim?	24

3.4 Trafikimi në faqe të parë	—	27
3.5 Trafikim pa viktime trafikimi	—	29
3.6 Burimet e informacionit për trafikimin e grave dhe vajzave	—	36
3.7 Fotot	—	38
3.8 Konfidencialiteti dhe publikimi i të dhënave personale	—	40
3.9 Ndjekja e lajmeve	—	42
3.10 Gazetarët	—	44
KAPITULLI IV: REKOMANDIME	—	47
SHTOJCA 1.		
Kriteret dhe indikatorët e përdorur në monitorim	—	50

SHKURTIME

TGV	Trafikimi i grave dhe vajzave
VT	Viktimë trafikimi
UN WOMEN	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
EIDHR	Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrimin
OJF	Organizata Jo-Fitimprurëse
FB	Facebook

● ● ● ● PARATHËNIE

Media është një aktor i pazëvendësueshëm në informimin e publikut lidhur me të gjitha problematikat që e prekin atë drejtpërdrejt apo tërthorazi, veçanërisht lidhur me çështje që kanë në fokus informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut. Trafikimi në njerëz dhe në veçanti ai i vajzave dhe grave është një fenomen që ka nevojë për profesionistët e medias për të informuar, mobilizuar dhe përfshirë publikun, duke ndihmuar kështu në parandalimin dhe në luftën kundër trafikimit. Nga konsultimet e shumta me profesionistë të medias, kemi kuptuar se sa e vështirë është që të ruhet ekuilibri midis profesionalizmit dhe domosdoshmërisë për të bërë bujë me lajmin që po raportohet, shpesh kjo e dyta duke rënduar mbi profesionalizmin.

Të dashur gazetarë, redaktorë e kryeredaktorë të mediave! Ndikimi i pamohueshëm që keni në formimin e opinionit publik, ju jep në dorë një armë të fuqishme për ndryshim dhe përparim shoqëror, duke nënkuptuar njëkohësisht edhe një përgjegjësi të madhe nga ana juaj. Historitë që ju sillni dhe mënyra si ia ofroni ato publikut tuaj, edukojnë në një mënyrë të caktuar publikun, ndërkohë që e informojnë atë. Një rast trafikimi i raportuar me ndjeshmëri ndaj viktimës, të drejtave të njeriut dhe ruajtjes së konfidencialitetit për të mos rënduar edhe më situatën e viktimës apo cënuar efektivitetin e organeve ligjzbatuese si policia, prokuroria dhe gjykatat, është një mundësi e artë jo vetëm për të informuar, por edhe për të ndërgjegjësuar publikun rreth dimensioneve të kësaj problematike mjaft të ndërlikuar, shpesh të pakuptuar mirë, paragjykuar dhe nënvlerësuar nga publiku, si edhe nga vetë profesionistët e medias.

Kriteret bazë të profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe etikës në raportimin e rasteve të trafikimit të vajzave dhe grave, janë kryefjalët e këtij raporti monitorimi të medias së shkruar, duke na dhënë kështu një panoramë të asaj çfarë ndodh me raportimin e kësaj problematike. Gjetjet janë shtysa shumë të rëndësishme, pasi Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim dhe Njësia e Medias pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, me mbështetjen e UN Women Shqipëri ka ndërtuar mbi to, duke hartuar manuale dhe paketa ndihmëse për gazetarët, duke ofruar mundësi trajnimi, duke përmirësuar e forcuar urat e komunikimit midis medias dhe aktorëve publikë e jo-publikë që punojnë me trafikimin e vajzave dhe grave, e rrjedhimisht duke rritur dalëngadalë cilësinë e raportimit në media. Ka akoma shumë punë për t'u bërë, por për aq kohë sa e konsiderojmë njëri tjetrin partnerë në parandalimin dhe përpjekjet kundër trafikimit të vajzave e grave, misioni ynë i përbashkët bëhet gjithnjë e më i realizueshëm.

Ju falenderojmë përzemërsisht për bashkëpunimin!

Dr. Elona Gjebrea

Zëvendësministre e Punëve të Brendshme

Koordinatorë Kombëtare për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të

Personave

HYRJE



Ky dokument është një raport monitorimi i shtypit të shkruar në Republikën e Shqipërisë lidhur me trafikimin e grave dhe vajzave. Raporti është pjesë e një projekti më të gjerë të zbatuar nga UN Women dhe Ministria e Brendshme, mbështetur nga Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR).

Trafikimi i qenieve njerëzore mbetet një shqetësim për shoqërinë dhe autoritetet shqiptare, që pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme, përballen me sfida të cilat e kufizojnë reagimin e qëndrueshëm dhe efikas ndaj kësaj dukurie, të njohur si “skllavëria e kohëve moderne.” Studimet tregojnë se faktorët kryesorë që çojnë në trafikimin e grave dhe vajzave janë të lidhur ngushtë me kushtet e vështira ekonomike të tyre. Faktorë të tjerë përfshijnë ndërgjegjësimin e pakët rreth ekzistencës së kësaj dukurie, perceptimet e zbkuruara në lidhje me punën jashtë vendit ose me martesat, etj. Dhuna në familje është gjithashtu një faktor i rëndësishëm që e rrit rrezikun e rënies pre të vajzave dhe grave në rrjetet e trafikimit të qenieve njerëzore.

Media luan një rol të rëndësishëm në luftën kundër trafikimit dhe dhunës me bazë gjinore, sidomos për sa i takon ndërgjegjësimin e popullatës për përmasat e fenomenit, mënyrat e parandalimit të tij, si dhe në lidhje me ushtrimin e presionit pozitiv mbi autoritetet përgjegjëse.

Raporti është i ndarë në 4 kapituj kryesorë: konteksti, metodologjia, gjetjet kryesore dhe rekomandimet. Në kapitullin e parë shpjegohet konteksti i medias shqiptare, kuadri ligjor në të cilën ajo vepron, si dhe qëllimet e monitorimit. Në kapitullin mbi metodologjinë jepen shpjegime për kampionin e përzgjedhur, si dhe variablat që janë marrë në shqyrtim. Gjithashtu, në këtë kapitull përfshihen dhe pyetjet të cilave raporti synon t’u përgjigjet. Në kapitullin e tretë, jepen gjetjet kryesore të monitorimit sipas elementëve kryesorë të raportimit, si dhe sipas autorëve. Në kapitullin e fundit renditen disa rekomandime për përmirësimin e raportimit të trafikimit të grave dhe vajzave në Shqipëri.

KAPITULLI 1

KONTEKSTI

Trafikimi i qenieve njerëzore dhe, në veçanti, trafikimi i grave dhe vajzave është një problem bashkëshoqërues i tranzicionit postkomunist në Shqipëri. Që në momentet e para të shfaqjes së kësaj dukurie, media dhe në veçanti, mediat e lajmeve kanë raportuar vazhdimisht rreth saj, duke ndjekur të gjithë dinamikën e saj, e cila nisi fillimisht me konstatimin e dukurisë, punën e institucioneve shtetërore për parandalimin e trafikimit, fushatat ndërgjegjësuese dhe më vonë, ngritjen e shërbimeve specifike rehabilituese dhe integruese për të mbijetuarat e trafikimit. Përveç lajmeve dhe reportazheve, ka pasur edhe dokumentarë të posaçëm televizivë¹ ose seri debatesh televizivë rreth trafikimit,² etj.

Paralelisht me zhvillimin e raportimit për dukurinë e trafikimit të grave dhe vajzave (TGV), janë kryer edhe monitorime për të

¹ TV Klan, Majlinda Bregu, 2000.

² "E nesërmya e harruar", TVA, 2001, seri debatesh televizive mbështetur nga Ambasada amerikane.

kuptuar dinamikën e këtij raportimi, pikat e dobëta dhe të forta të tij. Monitorimi i parë me fokus trafikimin u krye më 2007 nga Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim, ndërsa në 2010, Organizata Ndërkombëtare për Migrimin, IOM, mbështetur nga Organizata Austriake për Zhvillim, mbështeti një monitorim tjetër për raportimin e trafikimit dhe dhunës ndaj grave në media.³

Përfundimet e të dy monitorimeve të rasteve të trafikimit kanë treguar se pavarësisht dëshirës së mirë dhe gatishmërisë për të denoncuar këtë dukuri shqetësuese, shpesh gazetarët janë treguar të interesuar për rastet specifike apo "skupet", duke çuar në stigmatizimin e mëtejshëm të viktimave. Ka pasur raste të zbulimit të identitetit të të mbijetuarave, gjë që ka shkatërruar besimin mes medias dhe institucioneve përgjegjëse për reagimin ndaj trafikimit, pasi ka vënë realisht në rrezik jetën e njerëzve. Janë

³ Mbulimi i trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës në familje në mediane e shkruar ndër vite – Një qasje krahasuese, IOM, 2010.

bërë pak ose aspak analiza të thelluara të shkaqeve që çojnë në trafikimin e grave dhe vajzave. Diversifikimi i burimeve të informacionit është bërë me një ritëm të ngadaltë, por gjithsesi, ato mbeten të pamjaftueshme për një pasqyrim realist të dukurisë së trafikimit. Nga ana tjetër, janë vërejtur mbulime sipërfaqësore, përdorim i gabuar dhe jo etik i gjuhës në lidhje me viktimat e trafikimit, mos ndjekje të lajmeve pasi ato ndodhin, etj.⁴

1.1 KUADRI LIGJOR PËR MEDIAT

Në Shqipëri, nuk ka një ligj të posaçëm për shtypin, por vetëm për mediat audiovizive. Standardet profesionale nuk mbikëqyren nga organe të posaçme si *Urdhri i gazetarit*, *Këshilli i shtypit* apo *Këshillat e etikës*, të cilat nuk ekzistojnë. Standardet profesionale që përdoren nga gazetarët në shkrimin e artikujve janë minimale (jo shkrime pa burim). Kritika ndaj tyre vjen gjithmonë nga aktorë të jashtëm (konsulentë, pedagogë, studiues) dhe nuk ka studime që të tregojnë sesi është reaguar ndaj këtyre kritikave, çfarë masash janë marrë për minimizimin e gabimeve dhe përmirësimin e standardeve të raportimit.

Si matës për profesionalizmin e medias

⁴ Po aty.

shërben zbatimin e *Kodit të Etikës*, i hartuar në vitin 1996 dhe i rishikuar në vitin 2006. Kodi është mbështetur nga shoqatat kryesore të gazetarëve që veprojnë në vend. Megjithatë roli i dobët i këtyre shoqatave, si dhe karakteri jodetyrues i Kodit ka sjellë shkeljen e vazhdueshme të tij dhe mungesën e pasojave për gazetarët apo mediat ku ata punojnë. *Unioni i Gazetarëve Shqiptarë*, i cili konsiderohet si organizmi më i madh i gazetarëve në vend, me 850 anëtarë, është një entitet jofitimprurës, i cili vepron më shumë si një ombrellë që mbron të drejtat e gazetarëve për sa i takon statusin e tyre profesional, kontratatave me punëdhënësit, marrëdhëniet me autoritetet, etj.

Në historinë e shtypit shqiptar të tranzicionit demokratik, vetëm një media ka ngritur *Këshillin vetjak të Etikës*⁵, por në përgjithësi një praktikë e tillë nuk është e përhapur nëpër redaksi. Kohët e fundit janë bërë disa përpjekje për të krijuar *Avokatin e lexuesve*,⁶ brenda gazetës, po sërish këto përbëjnë një rast të izoluar.

Shqipëria ka dhe një kod të posaçëm për raportimin e rasteve të trafikimit,⁷ publikuar në faqen e *Institutit Shqiptar të Medias*,

⁵ Gazeta Shekulli.

⁶ Gazeta Mapo.

⁷ Grupi Shqiptar i Grave në media, "Kodi i Etikës për mediat dhe trafikimin e qenieve njerëzore".

por nuk ka të dhëna se sa prej redaksive e kanë pranuar dhe e zbatojnë atë. Publiku ka njohuri të pakta në lidhje me median dhe të drejtat e tij në raport me të dhe për të kërkuar respektim të normave të etikës në shtyp.

1.2 QËLLIMI I MONITORIMIT

Monitorimet e kryera deri tani janë përqendruar kryesisht në çështje të etikës gazetareske dhe mbi të gjitha mbulojnë periudha të shkurtra kohore. Në mënyrë që të ndërtohet një bazë e besueshme të dhënash, që të dokumentojë të gjithë këtë problematikë në raportimin e trafikimit në media dhe të japë zgjidhje për përmirësimin e saj, u ndërmor një monitorim më i thellë, me një kampion më të plotë, për një periudhë më të gjatë kohore, duke filluar nga 1 shkurti 2014 deri më 31 dhjetor 2014.

Qëllimi i monitorimit është të japë një pasqyrë të plotë të raportimit të trafikimit dhe të identifikojë disa probleme kyçe në mënyrën sesi media e shkruar raporton sot për sot mbi trafikimin e grave dhe vajzave në Shqipëri. Mbi të gjitha, ky monitorim synon të ofrojë zgjidhje konkrete për mënyrën e përmirësimit të raportimit të rasteve të trafikimit të grave dhe vajzave, në dobi të luftës së përbashkët, por të munguar kundër këtij fenomeni.

Gjetjet e monitorimit do të shërbejnë për formulimin e disa rekomandimeve kryesisht për vetë gazetarët, por edhe për aktorët e tjerë kryesorë në luftën ndaj trafikimit. Këto rekomandime do të synojnë zhdukjen e hendekut ekzistues mes medias, si një partnere në luftën kundër trafikimit, dhe institucioneve publike përkatëse. Gjetjet do t'u shpërndahen një rrjeti aktorësh si :

1. Drejtuesve të mediave
2. Gazetarëve
3. Universiteteve/studentëve të gazetarisë
4. Policisë/ zyrave të shtypit
5. OJF-ve

ZHANRI I PËRDORUR ME SHPESH NË RAPORTIMIN E TRAFIKIMIT

98,7%

lajm i shkurtër me 1 ose 2 paragrafe

Raportimi rreth trafikimit të grave dhe vajzave në Shqipëri mbetet në nivelin e lajmeve telegrafike, të cilat ndalen në shtresën e parë të raportimit dhe nuk i japin përgjigje pyetjes “pse”. Vetëm në 0.8% të artikujve të monitoruar, vërehen përpjekje të pakta për të hedhur dritë mbi shkaqet dhe faktorët që i shtyjnë gratë dhe vajzat të bien pre e trafikimit. Gjini të tilla si investigimi dhe reportazhi mungojnë plotësisht (0% artikuj).

KAPITULLI 2

METODOLOGJIA

Shqipëria ka një skenë të larmishme mediatike, me një numër të madh mediash të shtypura, audiovizuale dhe online. Për fat të keq, mungojnë të dhënat e tirazhit, shikueshmërisë dhe lexueshmërisë për shtypin e shkruar, si edhe për televizionet. Kjo e vështirëson përzgjedhjen e kampionit, pavarësisht se ekziston një perceptim i përgjithshëm lidhur me gazetatat më të mëdha në treg, ose televizionet më të shikuara.

2.1 KAMPIONI

Për ciklin e parë të monitorimit, i cili mbulon periudhën 1 shkurt – 31 dhjetor 2014, monitorimi i medias në lidhje me trafikimin, do të përqendrohet ekskluzivisht në shtypin e shkruar, për shkak të rregullsisë së paraqitjes të tij dhe ekzistencës së arkivave faktike të gazetave. Edhe pse media elektronike i kushton rëndësi raportimit të trafikimit, jo të gjitha mediat i hedhin kronikat e ditës rregullisht në faqet e tyre online, çka e bën të pamundur krahasimin. Arsyeja tjetër pse është zgjedhur media e

shkruar ka të bëjë me faktin se disa nga gazetatat kryesore janë pronë e kompanive mediatike, të cilat përfshijnë edhe televizione (Shqip-Top Channel, Gazeta Shqiptare-News 24, Shqiptarja.com-A1Report). Një sinergji e tillë e mediave brenda kompanive bën që lajmet të kalohen nga televizioni në gazeta, ndonjëherë edhe fjalë për fjalë, sidomos kur bëhet fjalë për investigime. Në këtë mënyrë, gazetatat na japin disa të dhëna të asaj çka raportohet në televizione për trafikimin. Për efekt të këtij monitorimi, do t'u referohemi të dhënave të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë (UGSH). Sipas UGSH-së, gazetatat e përditshme në Shqipëri ndahen në tre kategori:

1. Grupi i parë, me tirazh prej 5000-18.000 kopjesh në ditë:
 - a. Panorama
 - b. Dita
 - c. Sot
2. Grupi i dytë, me tirazh prej 2500-3000 kopjesh në ditë:
 - a. Shqip
 - b. Mapo

- c. Gazeta Shqiptare
 - d. Shqiptarja.com
 - e. Shekulli
3. Grupi i tretë me tirazh prej 1500-2000 kopjesh në ditë:
- a. Standard
 - b. Republika
 - c. 55
 - d. Tema

Në funksion të metodologjisë së këtij monitorimi, do të përfshihen vetëm mediat e grupit të parë dhe të dytë, gjithsej 8 gazeta të përditshme.

2.2 KRITERET DHE KUFIZIMET

U monitoruan 8 gazeta të përditshme për periudhën 1 shkurt 2014–31 dhjetor 2014: Panorama, Dita, Sot, Shqip, Mapo, Gazeta shqiptare, Shqiptarja.com dhe Shekulli.

Metodologjia përfshin instrumente matëse si cilësore ashtu dhe sasiore.

Në monitorimin cilësor, por edhe sasior, variablat që u shqyrtuan kishin të bënin me:

- Hapësirën që i kushtohet trafikimit
 - Nr. e faqes (faqe e parë, krye lajm-faqet e brendshme)
 - Rubrika (aktualitet, kronikë, sociale)
- Zhanri i artikullit
 - lajm
 - reportazh
 - investigim
 - analizë
 - opinion/ editorial
- Burimet e përdorura
 - numri i burimeve në një artikull
 - larmia e burimeve
- Terminologjia/gjuha e përdorur për:
 - viktimat e trafikimit
 - trafikimin dhe format e tij;
- Ruajtja e të dhënave personale dhe privacisë së protagonistëve (të mbijetuarat e trafikimit, punonjësit e policisë që hetojnë çështjet e trafikimit ose punonjësit socialë që merren me rehabilitimin e viktimave);
- Mbulimi grafik/ilustrues i artikujve (fotot e përdorura);
- Mbulimi i trafikimit si dukuri;
- Llojet e trafikimit të raportuara:
 - trafikim i brendshëm/trafikim i jashtëm
 - trafikim për prostitucion/trafikim për lypje/ trafikim për punë të detyruar, etj.
- Raporti midis artikujve ndërgjegjësues dhe informativë mbi trafikimin;

- Gazetarët që shkruajnë për trafikimin:
 - gjinia
 - profili
- Raportimi i rasteve të trafikimit edhe pas ditës së ngjarjes;
- Artikuj të lidhur drejtpërdrejt me trafikimin/artikujt ku trafikimi nuk del si temë qendrore, por përmendet si histori në një artikull që ka tjetër temë në fokus/artikuj që japin të gjithë sinjalet e një rasti trafikimi, por nuk e identifikojnë atë si të tillë në trajtim apo terminologji.

Analiza dhe krahasimi i këtyre variablave mbështetur në Manualin “Raportimi i rasteve të trafikimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave” do të mundësojë një kuadër të plotë dhe të qartë të problematikës që haset në media për raportimin e trafikimit. Gjithashtu, monitorimi do të shërbejë edhe si bazë për formulimin e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e tyre.

Në një mënyrë më të përmbledhur, mund të themi se monitorimi përpiqet t’u japë përgjigje këtyre pyetjeve:

1. Cilat janë karakteristikat kryesore të raportimit të trafikimit të grave dhe vajzave në shtypin shqiptar?
2. Cili është kuptimi i trafikimit të grave dhe vajzave për median shqiptare?

3. Cilat janë pikat e dobëta të këtij raportimi dhe nga cilët faktorë shkaktohen ato?
4. Cilat janë burimet kryesore të informacionit që përdoren nga media në raportimin e trafikimit të grave dhe vajzave? Si kontrollohen burimet?
5. Cili është raporti midis artikujve informues, ndërgjegjësues dhe investigativë për rastet e trafikimit?
6. A ndikon gjinia dhe profili i gazetarëve në cilësinë e raportimit të trafikimit?
7. Cili është raporti midis raportimit ditor dhe ndjekjes në vazhdimësi të rasteve të trafikimit?
8. Cili është raporti midis artikujve përshkrues dhe atyre analitikë?
9. Cili është raporti midis artikujve që shkruajnë për viktimat/të mbijetuarat e trafikimit dhe ri-integrimit të tyre?
10. A përputhen titujt me brendinë e artikujve për trafikimin e grave dhe vajzave?
11. Si portretizohen gratë dhe vajzat-viktima të trafikimit? A seksualizohen ato? A paragjykojnë? A kritikohen/fajësohen?

Rezultatet e gjetura u interpretuan në bazë të praktikës më të mirë gazetareske dhe

“Trafikimi i qenieve njerëzore nënkupton rekrutimin, transportimin, zhvendosjen, fshehjen ose pritjen e njerëzve, përmes kanosjes, përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit me forcë, mashtrimit, abuzimit me pushtetin, apo vendosjes në një pozitë të pambrojtur, përmes dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve të tjera, me synimin për të realizuar shfrytëzimin e një individi nga një individ tjetër, për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll ndaj një personi tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin, minimalisht, shfrytëzimin e prostitucionit të personave të tjerë ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërimin ose heqjen e organeve.”⁹

Manualit “Raportimi i rasteve të trafikimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave”.⁸

Duke qenë se raportimi i trafikimit të grave dhe vajzave në media bëhet edhe në medime të tjera si media elektronike, të cilat kanë edhe ndikim më të madh tek audienca për shkak të mbërritjes më të shpejtë të lajmit dhe teknologjive të përparuara, përfundimet e këtij monitorimi do të kufizohen vetëm me raportimet e medias së shkruar.

Monitorimi i vitit të ardhshëm do të fokusohet në medimet televizive, duke e plotësuar panoramën dhe zgjidhur këtë kufizim të përkohshëm.

⁸ Manuali për raportimin e trafikimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave, Tiranë, 2014

⁹ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkufitar, AP. Rez. 25, Aneksi I, U.N. GAOR, Ses. 55, Supl. Nr. 49, në 44, Dok OKB. A/45/49 (Vëll. I), 2001. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkufitar, AP. Rez. 25, Aneksi I, U.N. GAOR, Ses. 55, Supl. Nr. 49, në 44, Dok OKB. A/45/49 (Vëll. I), 2001.

KAPITULLI 3

GJETJET E MONITORIMIT

3.1 KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË RAPORTIMIT TË TRAFIKIMIT TË GRAVE DHE VAJZAVE NË SHTYPIN SHQIPTAR:

- Raportimi rreth trafikimit të grave dhe vajzave (TGV) në shtypin shqiptar, edhe pse ka njohur rritje në krahasim me vitin 2010, vazhdon të mbetet reagues, i fragmentarizuar dhe i mbështetur vetëm te një burim.
- 98.7% e artikujve për trafikimin e grave dhe vajzave janë lajme telegrafike, pa kontekst apo analizë.
- Mbështetja kryesisht tek burimet policore (64%) për shkrimin e artikujve tregon se në shtypin shqiptar, trafikimi konsiderohet më shumë si një problem rendi dhe sigurie, sesa një problem social apo i të drejtave të njeriut. Nuk ka asnjë rast kur gazetarët të marrin vetë nismën për të shkruar rreth trafikimit të grave dhe vajzave.
- Raportimi rreth trafikimit të grave dhe vajzave në shtypin shqiptar i “zhduk” viktimat e trafikimit. Viktimat e trafikimit etiketohen rëndom si “prostituta”, si dhe përdoren foto të papërshtatshme për ilustrimin e artikujve që lidhen me trafikimin, si p.sh: botohen 32% foto të “vajzave në rrugë”, krahasuar me 10% foto të trafikantëve.
- Trafikimi i qenieve njerëzore në raportimin e shtypit të shkruar vazhdon të ngatërrohet me kontrabandimin e personave (kalim i paligjshëm i kufirit), ose të përdoret emërtimi “trafik”, në vend të “trafikimit”, duke reflektuar njohje të mangët, kuptim të cunguar ose mosinteresim nga ana e gazetarëve apo drejtuesve të tyre për dukurinë e trafikimit të grave dhe vajzave.
- Raportimi rreth trafikimit të grave dhe vajzave në Shqipëri mbetet në nivelin e lajmeve telegrafike, të

cilat ndalen në shtresën e parë të raportimit dhe nuk i japin përgjigje pyetjes “pse”. Vetëm në 0.8% të artikujve të monitoruar, vërehen përpjekje të pakta për të hedhur dritë mbi shkaqet dhe faktorët që i shtyjnë gratë dhe vajzat të bien pre e trafikimit. Gjini të tilla si investigimi dhe reportazhi mungojnë plotësisht. (0% artikuj)

- Me përjashtime të rralla, nuk vërehen publikime të të dhënave personale të viktimave të trafikimit (VT). Megjithatë, në 16 raste janë publikuar të dhëna të tjera (mosha, vendbanimi, profesioni), të cilat çojnë në identifikim të tërthortë të viktimave të trafikimit.
- Në 31.5% të artikujve të monitoruar, edhe pse përmenden elementë të qartë të trafikimit të grave dhe vajzave brenda vendit për prostitucion, ai nuk raportohet si trafikim i brendshëm,. Kjo reflekton njohje të mangët të kuadrit ligjor të ndryshuar dhe vendosje të gabuar të theksit në raportim.
- Riintegrimi i viktimave të trafikimit është një subjekt që mungon në artikujt rreth trafikimit të grave dhe vajzave (0%) .

Analiza e këtyre gjetjeve dhe përkufizimi i trafikimit si më lart, na çon në konkluzionin se kuptimi i trafikimit të grave dhe vajzave për shtypin shqiptar është i mangët dhe nuk kuptohet siç duhet. Duke mos u raportuar në gjithë gjerësinë e vet, por thjesht si një lajm kronike, i fokusuar ose tek trafikanti, ose (rrallëherë) te viktima, trafikimi paraqitet si një marrëdhënie e konsumuar midis dy personave, dhe jo si një dukuri që ka shkaqe specifike kulturore e shoqërore dhe që shkel të drejtat njerëzore të grave.

Arsyet për këtë gjendje të raportimit të trafikimit të grave dhe vajzave në shtypin shqiptar mund të jenë të shumta dhe të natyrave të ndryshme, duke nisur që nga gjendja financiare e gazetave në Shqipëri, raportet midis gazetarëve, redaktorëve, kryeredaktorëve dhe pronarëve të gazetave, fokusi i gazetës, burimet në dispozicion, etj. Në këto kushte, do të ishte e këshillueshme që të ndërmerrej një studim tjetër për gazetarët dhe mediat që shkruajnë rreth trafikimit, i cili të nxirrte në mënyrë të plotë dhe të thelluar arsyet për këtë gjendje të raportimit mbi trafikimin në Shqipëri.

3.2 TRAFIKIMI I GRAVE DHE VAJZAVE - NJË PAMJE E PËRGJITHSHME


Për periudhën 1 shkurt – 31 dhjetor 2014, u

monitoruan afërsisht 2640 gazeta dhe u identifikuan gjithsej 245 artikuj që trajtojnë çështjet e trafikimit. Shpërndarja sipas muajve është si më poshtë:

Siç shihet edhe nga grafiku, në muajt e parë të vitit ka një intensitet më të madh shkrimesh për trafikimin, ndërsa pas muajit maj, numri

i artikujve është mesatarisht i përafërt. Siç do ta shohim edhe tek analiza e burimeve, nuk ka asnjë rast kur gazetaret të marrin nismën për të shkruar rreth trafikimit të grave dhe vajzave. Shqetësues mbetet fakti që, edhe pse në muajin tetor të këtij viti pati rreth 60 veprimtari në kuadër të javës Anti-trafikim, numri i artikujve është ndër më të

Grafiku nr. 1: Frekuenca e artikujve për trafikimin e grave dhe vajzave sipas muajve




ulët krahasuar me muajt e tjerë të vitit, duke treguar ose një mosinteresim të medias së shkruar për t'u marrë me këtë tematikë, ose që aktivitetet janë ideuar më shumë rreth mediave televizive.

Më shumë se gjysma e artikujve të përfshirë në monitorim, 53.7 %, janë "mundësi të

humbura", ose artikuj ku trafikimi i grave dhe vajzave nuk del si temë qendrore. Mundësi të humbura kemi quajtur ata artikuj të cilët mund të trajtoheshin në kuadrin e trafikimit të grave dhe vajzave, sipas përkufizimit të Konventës së OKB-së dhe Kodit Penal të Shqipërisë.


Grafiku nr. 2: Numri i artikujve të lidhur drejtpërdrejt me trafikimin e grave dhe vajzave



Koncepti i trafikimit për vitin 2014 në shtypin shqiptar mbetet i lidhur kryesisht me trafikimin jashtë vendit, duke lënë në hije një dukuri që po merr përmasa shqetësuese, siç është ai i trafikimit të brendshëm. Nga 130 artikuj, të paktën 41, që përfaqësojnë 31.5% të artikujve të këtij grupi, mund të kishin trajtuar temën e trafikimit të brendshëm, si

p.sh., në artikujt që raportojnë për vajza apo gra nga një qytet që “kapen” duke ushtruar prostitucion në qytete të tjera, ose për rastet e zbulimit të bazave të prostitucionit në qytete të ndryshme si Lushnje, Kamëz, Fier, apo Tiranë. Me përjashtime të rralla, në artikujt mbi operacionet e policisë për zbulimin e këtyre rrjeteve, flitet për

Grafiku nr. 3: Subjektet e trajtuara në artikujt për trafikimin e grave dhe vajzave



“pronarë biznesesh” dhe “prostituta”, duke lënë mënjanë faktin si kanë përfunduar ato vajza e gra aty, pra nuk ka një hulumtim të shkaqeve.

Në artikujt që lidhen drejtpërdrejt me trafikimin, 61% e tyre janë lajme të shkurtra, të kopjuara nga buletinet e policisë, me stil telegrafik, që flasin për arrestimet e personave të akuzuar për trafikim të qenieve njerëzore, apo për ekstradime.

Për fat të keq, edhe historitë e vajzave të trafikuar (10%), që mund të hidhnin dritë mbi trafikimin nga pikëpamja njerëzore dhe të tregonin pasojat reale të tij në jetën e viktimave dhe familjeve të tyre, janë më shumë “zbardhje” të detajeve të dosjes së përgatitur nga prokuroria, ose nga deponimet para policisë, dhe jo biseda të drejtpërdrejta apo intervista me të mbijetuarat. Vetëm në dy raste kemi histori të viktimave të trafikimit, të treguara nga vetë të mbijetuarat.

Mbështetja e madhe të burimet policore tregon se trafikimi konsiderohet kryesisht një problem rendi dhe sigurie, dhe jo një problem social apo i të drejtave të njeriut. Gazetarët që shkruajnë për trafikimin janë kryesisht gazetarë të kronikës, çka bën që pjesa sociale të lihet e pambuluar. Kjo shpjegon faktin pse nuk kemi asnjë histori riintegrimi të vajzave ose hulumtim të shkaqeve. Edhe ato shkrime që tentojnë të


shkojnë disi më në thellësi, i marrin detajet nga dosja e policisë, e cila nuk mund të jetë e plotë nga pikëpamja e elementëve që duhen për të pasqyruar një histori trafikimi.

3.2.1 Llojet e trafikimit të pasqyruar në shtyp

Trafikimi për qëllime prostitucioni është tema mbizotëruese në raportimet e monitoruara, me një numër modest artikujsh që flasin për llojet e tjera të trafikimit- për lypje apo punë të detyruar. Ky mbizotërim mund të shpjegohet me numrin e lartë të deklarimeve të policisë për operacione që lidhen me trafikimin e grave dhe vajzave dhe me mbështetjen e tyre vetëm tek burimet policore të trafikimit.

Trafikimi i të miturve dhe shfrytëzimi i tyre për lypje del në artikujt e marrë nga media e huaj (“Kalvari i tre fëmijëve shqiptarë në trafikuar në Greqi, ikja e arratisja” marrë nga gazeta greke “Kathimerini”) ose në artikuj që kanë në fokus studime më të gjera rreth gjendjes së fëmijëve të rrugës (“Fëmijët e humbur, çdo ditë, një i larguar nga shtëpia”), publikimi i raporteve nga vendet e destinacionit (“Trafiku seksual i të miturve në Britani, shumica nga Shqipëria”), ose nga aktivitete të zhvilluara gjatë javës anti-trafikim, si p.sh: “Kukës, rriten rastet e dhunës dhe të trafikimit të fëmijëve”.

Grafiku nr. 4: Llojet e trafikimit të pasqyruara në shtyp



3.3 RAPORTIM, INFORMIM APO NDËRGJEGJËSIM?

Në rrafshin e zhanreve të përdorur nga shtypi në periudhën e monitoruar, vihet re pothuaj mbizotërimi i plotë i lajmeve, gjysma e të cilëve janë vetëm një paragraf.

Zgjatja e lajmit përtej një paragrafi, varet nga komunikata e policisë dhe rëndësia e ngjarjes - operacione të mëdha, arrestime të shumta. Edhe në këto raste, titujt e vendosur synojnë të bëjnë “bujë” me detaje që nxjerrin në pah herë skena seksi, herë detaje të dhunimit - “Itali, tutori shqiptar i thyen krahun

NATYRA E BURIMEVE

Mbështetja kryesisht tek burimet policore për shkrimin e artikujve tregon se në shtypin shqiptar, trafikimi konsiderohet më shumë si një problem rendi dhe sigurie, sesa një problem social apo i të drejtave të njeriut. Nuk ka asnjë rast kur gazetarët të marrin vetë nismën për të shkruar rreth trafikimit të grave dhe vajzave.




prostitutës”, “I vendosin numrin në dorë për të treguar tarifën e shërbimit seksual,” “Pranga në Durrës, vrau një vajzë në Itali, e fshehu në frigorifer. Vrasja para 18 vitesh, nuk i bindej që të punonte prostitutë”, etj.

Vetëm në disa raste theksohen shkaqet që i kanë shtyrë vajzat dhe gratë drejt trafikimit, si

p.sh., kushtet ekonomike – “U bëra prostitutë me dhunë, familja jeton me paratë e mia”, “Seks me 3 mijë lekë: s’kemi mundësi të tjera mbijetese”, etj. Kur viktimat janë të rritura dhe të punësuar, nuk diskutohet në një plan më të gjerë pozita e brishtë e femrës shqiptare. Në anën tjetër, kur flitet për të mitura,

Grafiku nr. 5: Zhanri i artikujve për trafikimin e grave dhe vajzave



rrallëherë jepen shkaqet si, cenueshmëria psikologjike, probleme të familjes shqiptare, prishja e lidhjeve tradicionale, etj.

Për format e rekrutimit të viktimave të trafikimit, mund të lexosh midis rreshtave, në detajet e dosjeve të përgatitura për gjykatë, ose edhe në titull: “Mashtrocin vajzat për martesë, i shfrytëzonin për prostitute në Zvicër”, “Arrestohen tre punonjëse seksi, ishin të punësuar si balerina në një lokal”, “18 vjeçarja: Të dashurin e njoha në FB, më kërkoi të prostitutoja”, “R. joshte të dashurën me dhurata, nëna e 20-vjeçares e denoncon për trafik(im)”.

Nga 245 artikuj, kemi vetëm një (1) opinion në faqen e op/ed, lidhur me zbulimin e një baze prostitucioni në periferi të Tiranës, i cili nxjerr në pah lidhjen midis varfërisë dhe prostitucionit. Megjithëse, autori nuk e përmend drejtpërdrejt trafikimin, por kërkon nga shteti liberalizimin e prostitucionit, dhe nga ana tjetër, ndërhyrje për reduktimin e varfërisë së grave.

Në kategorizimin e shkrimeve si analiza, jemi përpjekur me dëshirën e mirë të fusim ato shkrime të cilat përpiqen të paraqesin një këndvështrim ndryshe të fenomenit të trafikimit, duke përdorur të dhëna nga raportet ndërkombëtare, apo organizatat jofitimprurëse, edhe pse analiza kërkon një përkufizim shumë më të thelluar të tij. Gjithashtu ka një përpjekje për të analizuar

rastet e fëmijëve që trafikohen për lypje/ shfrytëzim seksual jashtë vendit, duke ngritur disa pyetje, të cilat gjithsesi nuk marrin përgjigje.

Artikujt ndërgjegjësues, të cilët mund të marrin shkas nga nisma si ajo e aplikacioneve elektronike për parandalimin e trafikimit, apo nga studime të ndryshme, janë fare të pakët. Një shembull i mirë është artikulli “Një aplikacion anti-trafikim” që jep një panoramë të zgjeruar për llojet e trafikimit dhe mënyrat si mund të bihet pre e tij.


3.4 TRAFIKIMI NË FAQE TË PARË

Vetëm 14 raste, ose 5.3% e artikujve për trafikimin kanë qenë në faqe të parë të gazetave të monitoruara. Nga këto, vetëm 2 herë, artikujt për trafikimin e grave dhe vajzave kanë qenë krye lajm me titujt e mëposhtëm (pasqyruar me të kuqe në kolonën faqja 1):

“Harta e prostitucionit-zv/ ministrja:spostohet në bregdet”.

“ E mitura akuzon biznesmenin- si u mashtrua gjimnazistja dhe kërcënimet për të mos ikur nga rrjeti”.

Grafiku nr. 6: Vendi i artikujve në gazetë



Lajmet për TGV përfundojnë në faqe të parë kur bëhet fjalë për operacione të bujshme të policisë për shkatërrimin e bazave të prostitucionit në vend ose jashtë saj, dënime të trafikantëve dhe raporte të Departamentit Amerikan të Shtetit.

Natyrisht, fokusi është i ndryshëm për gazeta

të ndryshme, megjithatë edhe në ato raste kur lajmi për trafikimin e grave dhe vajzave zë faqen e parë, qëllimi është më shumë sensacioni, sesa ndriçimi i problemit. P.sh., në artikullin me titull :

“Adoleshentja, seks në grup, arrestohet i dashuri dhe babai i tij,” nuk kuptohet që



bëhet fjalë për shfrytëzim prostitucioni të një të miture- që sipas legjislacionit klasifikohet si trafikim i brendshëm, por për një "trill" të një adoleshenteje që "bën seks në grup". Ose intervista e Zv/ministres së brendshme, e cila është dhe Koordinatorë Kombëtare për Anti-trafikimin, është lajmëruar me një titull që rreket të bëjë bujë – "Harta e prostitucionit"- sesa të lajmërojë për rritjen alarmante të rasteve të shfrytëzimit të grave dhe vajzave brenda vendit për prostitucion.

Një mundësi tjetër e humbur për të folur për trafikimin e brendshëm, është operacioni i policisë në Elbasan, i cili zbuloi shfrytëzimin e një studenteje për prostitucion. Madje lajmi që pason ngjarjen, - shkresa e Ministrisë së Brendshme drejtuar komisariateve për mbajtjen nën mbikëqyrje të lokaleve të

natës- interpretohet në mënyrë të gabuar, duke përgjithësuar "studentet" që bëjnë "prostitutat e luksit në lokalet e natës," edhe pse burimi kryesor nuk e përmend një gjë të tillë. Duke anashkaluar pjesën e shtrëngimit, shfrytëzimit, kërcënimit dhe kushtet e tjera që i bëjnë vajzat të brishta ndaj trafikimit, vajzat studente gati fajësohen gjykohen në grup dhe nxirren para opinionit publik në një dritë që i bën ato të duken si "vajza të përdala" që kanë zgjedhur të "bëjnë" prostitutën e luksit, në vend që të mësojnë.


3.5 TRAFIKIM PA VIKTIMA TRAFIKIMI

"Për gazetarët, që shkruajnë për trafikimin, duhet të jetë e qartë se kur një histori ka të bëjë me "prostituta", në të vërtetë ajo ka të bëjë me shkeljen dhe dhunimin e të drejtave themelore të njeriut. Pa pasur parasysh moshën, vendin nga vinë, arsimin ose të kaluarën, të gjithë këto gra janë pikësëpari viktime. Asnjë punëtore seksi nuk ka pranuar me dëshirë të rrihet, të përdhunohet, ose të detyrohet të drogohet".¹⁰

Një nga problemet më shqetësuese të raportimit rreth trafikimit të grave dhe vajzave në shtypin shqiptar mbetet gjuha që përdoret

¹⁰ Manual për raportimin e rasteve të trafikimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave, UN Women 2014.

Grafiku nr. 7: Terminologjia e përdorur për viktimat e trafikimit dhe trafikimi i grave dhe vajzave



për to. Nëse nuk flasim për viktimat e trafikimit, por për "prostituta" (14 raste të konstatuara), raportimi i dukurisë do të mbetet i mangët dhe i pavërtetë. Edhe pse tregohet një kujdes më i madh në përdorimin e shprehjeve lidhur me vajzat e shfrytëzuara për trafikim, në krahasim me vitet e kaluara, sërish vihen re përdorime shprehjesh të gabuara për etiketimin e viktimave të trafikuar.

Shprehjet "punonte si prostitutë", "ushtronte profesionin e saj" nuk janë të vërteta në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore. Vajzat dhe gratë e trafikuar shfrytëzohen, detyrohen të punojnë si prostituta dhe nuk "ushtrojnë" kurrfarë profesioni, pasi nuk e kanë zgjedhur atë. Duhet të jetë e qartë se nuk ka prostituta në trafikim.

SHEMBUJ TË PËRDORIMIT TË GABUAR TË GJUHËS NË LIDHJE ME VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

*"**Prostitutat**, të gjitha me kombësi rumune, **punonin** në rrugë të ndryshme në Napolit...".*

*"Policia ka konfirmuar se janë shfrytëzuar gjithsej **15 prostituta rumune**, të moshës 18-23 vjeç...".*

*"Afrikani, shpërndarës droge, qëndronte pranë një **prostitute shqiptare**, teksa ajo "po punonte...".*

*"Itali, kapen tre shqiptarë, vranë afrikanin se i largoi klientët **prostitutës së tyre**". "Itali, tutori shqiptar i thyen krahun **prostitutës**".*

*"Tutori shqiptar rreh rumunin, u dashurua me **prostitutën e 'tij'** - një shtetas shqiptar dhe 5 persona të tjerë kanë ushtruar dhunë ndaj një prostitute dhe të dashurit të saj rumun.... Tutorët e torturojnë **prostitutën**...".*

*"Studente në Tiranë, **prostitutë në Elbasan**".*

*"Tiranë, shfrytëzimi i **studentes prostitutë**, vijojnë hetimet".*

*"Tiranë, **kamerierja prostitutë**, arrestohet pronari i hotelit,e cila detyrohej nga shefi i saj për të prostituuar me klientët...".*

*"**Prostituta shqiptare**: maniaku m'i lidhi duar e këmbë, mund të më kryqëzonte dhe mua".*

*"Itali, vdekja e klientit, rëndohet pozita e **prostitutës shqiptare**".*

*"Rrihet për vdekje **prostituta shqiptare**".*

*"Gjendet e masakruar **prostituta shqiptare**".*

*"**Prostitutat**, sipas policisë, gjendeshin në vendet e origjinës të shfrytëzuesve..."*

*"E zhdukura gjendet **prostitutë**".*

SHEMBUJ TË PËRDORIMIT TË SAKTË TË GJUHËS NË LIDHJE ME VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

*“...pasi kishin detyruar prostituimin me dhunë të dy **femrave** nga Lituania. Të dyja **viktimat**, nga fshatra të ndryshme të Lituanisë, kanë deklaruar se u kishin thënë se do të fitonin para në Angli, duke punuar në bare ose si pastruese...”*

*“Këta të fundit kanë realizuar martesë fiktive me **vajzat e trafikuarra** për të kamufluar shfrytëzimin e tyre si prostituta”.*

Një rast specifik përbën historia e S.B. nga Fieri që u gjet pa jetë në Francë dhe që gazetaret e etiketuan si prostitutë, pavarësisht se në artikull flitet për “një konflikt për shfrytëzimin e saj”. Vetëm në një rast, gazeta ka marrë reagimin e familjarëve që e kundërshtojnë këtë etiketim, ndërsa për pjesën tjetër i referohet policisë franceze si “gruaja që shiste trupin e saj”. Në një rast tjetër, fotoja e një gruaje shqiptare të përshtirë në një hetim për vrasje, etiketohet si “prostitutë”, paraqitet me emër, mbiemër dhe me foto, pa sqaruar pozicionin e saj nëse ishte një punonjëse seksi që kishte zgjedhur të ishte e fillë, apo nëse kishte një tutor.

Në disa artikuj, flitet për rekrutim të vajzave dhe grave “të cilat duke u maskuar si këngëtare, valltare, kameriere apo banakiere, ofrojnë shërbime seksuale në këmbim të parave” – dhe fotoja ilustruese tregon punonjëse seksi në rrugë. Formulimi i fjalisë në këtë mënyrë e zhvendos vëmendjen nga shfrytëzuesit e tyre. Formulimi i saktë do të ishte “femra, të cilat shfrytëzuesit e tyre i maskojnë si këngëtare, valltare,...”.

Pse është e rëndësishme të përdoret termi i duhur dhe jo etiketimet e mësipërme? E para, për shkak të ngarkesës negative që mbart fjala “prostitutë”, në opinionin publik shqiptar, e cila nuk tregon asnjë lloj respekti dhe mirëkuptimi për to. Fjala “prostitutë” është fyese për gratë dhe vajzat, sepse përdoret për të sharë, prandaj duhet bërë dallimi. Po ashtu, nuk është e nevojshme

të jepen detaje me sa persona po shkonte një e mitur në momentin e arrestimit, apo sa paguhej për shërbimet seksuale, sepse ky këndvështrim e seksualizon lajmin, duke e zhvendosur vëmendjen nga shfrytëzimi i vajzave. Nëse gazetarët nuk e bëjnë dallimin midis viktimave të trafikimit dhe prostitutave, si mundet një lexues ta bëjë dallimin mes këtij titulli : “Rrëfimi i prostitutës: i hodha valium, i mora lekët” dhe “Gjendet e masakruar prostituta shqiptare”?

Gjithashtu vërehet përdorimi i gabuar i termit “trafikim”, duke “shpikur” togfjalësha që jo vetëm nuk kanë kuptim nga pikëpamja ligjore, por edhe e keqorientojnë publikun si p.sh., “trafik prostitucioni”, “trafik prostitutash”(9 raste), etj. Kur themi “trafik prostitutash”, gratë dhe vajzat zhvlerësohen në sytë e publikut, pasi konsiderohen mall, njësoj si trafikimi i lëndëve narkotike, armëve, etj. E njëjta gjë vlen edhe për togfjalëshin, që tashmë fatmirësisht është në zhdukje, “trafik i mishit të bardhë”, e cila e redukton femrën në një pjesë trupi, duke harruar se pas tij fshihen qenie njerëzore jo vetëm prej mishi e gjaku, por edhe me shpirt e mendje.

Në 15 raste përdoret gabimisht emërtimi trafik për trafikim. Është e rëndësishme të përdoren termat e duhur, pasi duhet të kuptohet se bëhet fjalë për trafikimin e qenieve njerëzore si një akt kriminal, që përfshin disa etapa sipas përcaktimit që kemi dhënë më lart, dhe se përmban në vetvete trafikimin për shfrytëzim prostitucioni,

TË ARRESTUAR

Shkollë Jos Nolit, 52 vjeç, banues në Kamicë, Malësi e Madhe
 Miroslav Miroslav, 60 vjeç, banues në Buzë Malësi e Madhe
 Miroslav Miroslav, 53 vjeç, banues në Koplak Malësi e Madhe
 Gjergj Nik Morinaj 49 vjeç, banues në Shkodër
 Filip Vjergj Kortunja, 55 vjeç, banues në Vëllojë Shkodër
 Eduard Bakalli, 53 vjeç, banues në Tiranë



PSE ËSHTË E RËNDËSISHME QË TË RAPORTOHET ME KUJDES PËR LLOJET E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE?

- Për të ndërgjegjësuar publikun në lidhje me format e rekrutimit (vajzat dhe familjarët e tyre);
- Për të parandaluar shfrytëzimin e mëtejshëm të grave dhe vajzave;
- Për të krijuar një opinion publik të shëndoshë që kundërshton trafikimin si një formë skllavërimi të grave dhe vajzave dhe merr pjesë aktivisht në parandalimin dhe denoncimin e tij;
- Për të kuptuar që për trafikimin, fajtorë janë trafikantët dhe jo vajzat dhe gratë e trafikuar;
- Për të lehtësuar ri-integrimin e viktimave të trafikimit;
- Për të ushtruar presion pozitiv ndaj strukturave shtetërore, që të marrin masa për parandalimin e trafikimit, sidomos për punësimin e grave dhe vajzave, për fuqizimin ekonomik, shkollimin, dhe edukimin e vazhdueshëm të tyre.

SHKURT

Greqi, m
lumë shqipta
puri

Shkupit 16 v
nisi në Prizren
nisi. Të pas
i Shkupit i
dhe me një 40-
le kolon dëbë
në 1000, por
Shkupit i
kërkim e të-
kërkim, shtoi
Specialit të
trajto e p
në i 1000 d
puni dhe p
në 2 p
40-vjeçat
griku i k
palligjite,
pasi leje p

ëta
e or-
tarve
simi,
erson.
llasara
tës për
aguris
a kishin
dhe deri
sinjalimi
ka vënë
henuar të
fikut ishte
edonia në
ta bullgare

te treme dhe me pas dergonestan në Meksikë.
Prej Meksikës, hynin në territorin e SHBA-ve,
në rrugë klandestine.

na në Tiranë e Kavajë, policia ka proceduar

TERMINOLOGJIA E PËRDORUR PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT DHE TRAFIKIMIN E GRAVE DHE VAJZAVE



Një nga problemet më shqetësuese të raportimit rreth trafikimit të grave dhe vajzave në shtypin shqiptar mbetet gjuha që përdoret për to. Nëse nuk flasim për viktimë trafikimi, por për “prostituta” raportimi i dukurisë do të mbetet i mangët dhe i pavërtetë.

Shprehjet “punonte si prostitutë”, “ushtronte profesionin e saj” nuk janë të vërteta në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore. Vajzat dhe gratë e trafikuar shfrytëzohen, detyrohen të punojnë si prostituta dhe nuk “ushtrojnë” kurrfarë profesioni, pasi nuk e kanë zgjedhur atë. Duhet të jetë e qartë se nuk ka prostituta në trafikim.

për lypje, për punë të detyruar, etj. Në këtë mënyrë jo vetëm informojmë publikun, por edhe e ndërgjegjësojmë atë për pasojat e kësaj veprimtarie të urryer.


Në fund, por jo më me pak rëndësi, vërehet se termi “trafikimi i qenieve njerëzore” ngatërrohet ose përdoret për kontrabandim të personave.

Janë të paktën 19 raste në periudhën e monitoruar që bëjnë këtë konfuzion.


3.6 BURIMET E INFORMACIONIT PËR TRAFIKIMIN E GRAVE DHE VAJZAVE

Problemi më i madh dhe i vazhdueshëm i raportimit rreth trafikimit të grave dhe

Grafiku nr. 8: Numri i burimeve të përdorura për artikujt mbi trafikimin e grave dhe vajzave



Grafiku nr. 9: Larmishmëria e burimeve të përdorura për trafikimin e grave dhe vajzave



vajzave mbetet mbështetja te një burim.¹¹ Në monitorimin tonë artikujt që kanë përdorur më shumë se një burim, duke

¹¹ Mbulimi i trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës në familje në medianë e shkruar ndër vite – Një qasje krahasuese, IOM, 2010

treguar urgjencën e përmirësimit të këtij elementi tejet të rëndësishëm të raportimit numërohen me gishtat e njëres dorë(5) ose përbëjnë vetëm 2%. Sipas Kodit të Etikës për Raportimin e trafikimit të grave dhe vajzave "analiza kërkon më shumë sesa një burim".

Edhe në artikujt me një burim, nuk përfshihen

të gjithë aktorët që luftojnë trafikimin. Siç e tregon dhe grafiku, 63 % e lajmeve për trafikimin, kanë si burim të vetëm policinë, ndjekur nga mediat e huaja dhe organizatat ndërkombëtare.

Mbështetja vetëm tek policia, përveçse nuk lejon një raportim dhe analiza të thelluara, krijon përshtypjen e gabuar se trafikimi i grave dhe vajzave është një problem i policisë dhe çështje e kronikave, duke lënë mënjanë aspektet e tjera që janë shpjeguar në Manual: faktorët social-ekonomikë, shëndetësorë, kulturorë, etj. Jo rastësisht, shkrimet që kanë si burime organizatat jofitimprurëse janë ato që sjellin një pamje tjetër të problemit dhe informacione më të pasura dhe të thelluara në lidhje me trafikimin. Megjithatë, monitorimi tregon se edhe brenda organizatave jofitimprurëse, organizatat që punojnë për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave nuk përdoren si burime.

Nga ana tjetër, mbështetja vetëm tek deklaratat e policisë, i bën informacionet që jepen të pakuptueshme për lexuesin. P.sh. “Në shkresën drejtuar të gjithë komisariateve, shprehet dhe shqetësimi për të ashtuquajturat prostituta të luksit, për të cilat nuk ka të dhëna në sistemin “Memex”. Ky tekst është riprodhuar fjalë për fjalë edhe në një gazetë tjetër, pa shpjeguar çfarë është sistemi Memex. Në analizën tonë, ky artikull konsiderohet një rast i humbur, pasi me një

material të tillë në dorë, gazetari mund të shkojë më tej, për të kuptuar mekanizmin se si luftohet trafikimi, shkaqet e tij, etj.


Në fund, por jo më pak e rëndësishme, në gjithë këto vite Shqipëria ka krijuar kapacitetet e veta për luftën ndaj trafikimit, të cilat mund të përdoren si burime në lajmet që mbulojnë trafikimin, siç është Komiteti Anti-trafikim, i cili përbëhet nga 16 institucione. Gjithashtu, në Shqipëri gjenden ekspertë, juristë, punonjës socialë, studiues, aktivistë, etj., që janë marrë me çështjet e trafikimit dhe kanë njohuri të thelluara mbi to, dhe që janë pjesë e rrjeteve rajonale, të cilët gjithashtu mund të merren si referenca kur shkruhet për trafikimin e grave dhe vajzave.

3.7 FOTOT

Para se të kalojmë te përdorimi i fotove në artikujt për trafikimin e grave dhe vajzave, duhet thënë se 45% e artikujve nuk kanë përdorur foto për ilustrim, pasi japin lajme telegrafike. Në 55% të rasteve kur ato janë përdorur, gjendja paraqitet si më poshtë:

Megjithëse ka një përmirësim në përdorimin e saktë të fotove për të ilustruar historitë e trafikimit, sërish vërehet përdorim i pavend dhe i pakujdesshëm i fotove të vajzave që shfrytëzohen si punonjëse seksi në rrugë. Këto lloj fotosh përdoren tre herë më shumë

Grafiku nr. 10: Fotot e përdorura në shkrimet për trafikimin e grave dhe vajzave



sesa, për shembull, në historitë ku flitet për trafikantë të arrestuar, ose pothuaj aq sa fotot e policisë, duke bërë që gabimisht kjo dukuri të shihet më shumë si një përplasje midis vajzave dhe policisë, sesa midis policisë dhe trafikantëve. Ky përdorim i pakujdesshëm vjen pikërisht nga mosnjohja e mjaftueshme e dukurisë së trafikimit dhe barazimi i padrejtë i punonjësve të seksit me viktimat e trafikimit.

Manuali për raportimin e trafikimit të grave dhe vajzave udhëzon që në rastet e arrestimeve apo dënimeve, duhet të përdoren fotot e trafikantëve të arrestuar, dhe jo të vajzave në rrugë, siç ka ndodhur, p.sh., në rastin e dënimit të dy vëllezërve në Shqipëri për trafikimin e grave dhe vajzave. Në dy raste, gra të përfshira në rrjetin e prostitucionit jashtë vendit janë treguar me emër, mbiemër dhe foto, çka përbën veç të tjerash, dhe shkelje të etikës në publikimin e të dhënave personale të viktimave të trafikimit.

Grafikët nuk janë përdorur asnjëherë në shkrimet për trafikimin, edhe pse praktikantët më të mira në këtë drejtim e rekomandojnë përdorimin e tyre si një mënyrë e thjeshtë, e kuptueshme dhe ilustruese për fenomenin, që nuk dëmton individin.

Një praktikë e mirë që vihet re dhe duhet nxitur është përdorimi i fotove ilustruese të grave të dhunuara, për të treguar se trafikimi

është një dukuri që bëhet me shtrëngim, me dhunë, etj. Gjashtë rastet e shënuara për vitin 2014, duhen nxitur të përdoren në raportimin e kësaj dukurie.


3.8 KONFIDENCIALITETI DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

“Trafikimi i qenieve njerëzore është një dukuri komplekse dhe një praktikë e urryer. Nëse jeni angazhuar në përgatitjen e një artikulli rreth trafikimit të qenieve njerëzore, çështjet më të mëdha të etikës së raportimit rreth njerëzve të pambrojtur dhe të prekur nga trafikimi, të mbijetuarit e tij, duhet të jenë në qendër të të gjithë hapave të ardhshme. Kur raportoni drejtpërdrejt gjatë punës me viktimat, duhet të bëni kujdes për të mbrojtur identitetet e personave që kanë vendosur të flasin dhe të tregojnë historitë e tyre.”¹²

Nga monitorimi rezulton se përgjithësisht ruhet anonimiteti i viktimave të trafikimit ose i vajzave që trafikohen për prostitucion, por ka një rritje të elementëve të identifikimit të tërthortë, siç janë inicialet e emrit dhe mbiemrit, mosha dhe vendbanimi (16 herë) ose origjina.

¹² Manuali për raportimin e rasteve të trafikimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave, 2014

Grafiku nr. 11: Të dhënat personale të viktimave të trafikimit



Kjo praktikë është veçanërisht e dukshme në rastin e viktimave të trafikimit të brendshëm, ku nuk mungojnë as rastet e identifikimit të drejtpërdrejtë, si në rastin e një të miture në Durrës, e cila u arrestua me akuzën e “ushtrimit të prostitucionit”.


Në këtë pikëpamje, së pari, deklaratat e policisë, por edhe gazetarët duhet të jenë të kujdesshëm që të mos japin të tilla të dhëna që çojnë në identifikimin e viktimave të trafikimit. Një rrugë e mesme do të ishte dhënia vetëm e moshës, p.sh., pa dhënë detaje të llojit si, viti i studimit, universiteti ku

studion dhe origjina, apo lokali ku punonte. Duhet kuptuar se, në çdo rrethanë, vajzat dhe gratë e trafikuar, brenda dhe jashtë vendit, janë viktime dhe, si të tilla, duhen mbrojtur nga riviktimizimi që vjen për shkak të stigmës dhe paragjykit. Detyra e gazetarëve, si edhe e aktorëve të tjerë, është mbrojtja dhe fuqizimi i viktimeve.

3.9 NDJEKJA E LAJMEVE

Ndjekja e lajmeve edhe pasi ato ndodhin, vazhdon të mbetet një tjetër pikë e dobët në raportimin e trafikimit të grave dhe vajzave, po duhet theksuar se ky nuk është problem vetëm për trafikimin, pasi në përgjithësi në median shqiptare nuk ndiqen rastet që raportohen.

Grafiku nr. 12: Ndjekja e rasteve të trafikimit të grave dhe vajzave pas ditës së ngjarjes



Në monitorimin tonë, nga 243 artikuj, vetëm tre e kanë ndjekur një ngjarje që lidhej me trafikimin). Vetëm ndjekja e lajmit mund të na japë një panoramë më të plotë të ngjarjes, duke i pasuruar të dhënat e marra nga komunikatat e policisë me këndvështrime të reja, si p.sh., me të dhëna të familjarëve, gjykatave, prokurorisë, etj.

Raportimi i një rasti trafikimi vetëm si një ngjarje e ditës na e kufizon pamjen, duke mos lejuar bërjen e analizave të thelluara, si dhe duke mos u dhënë mundësi palëve të përfshira në ngjarje të japin versionin e tyre. P.sh., nëse raportojmë vetëm arrestimet për trafikim dhe jo vendimet e gjykatave për to, mund të krijohet ideja se shumica e arrestimeve për trafikim nuk procedohen deri në fund. Nëse kjo është e vërtetë, cilat janë shkaqet? Nëse kjo ndodh për shkak të mos ndjekjes së lajmit, atëherë krijohet një shtrembërim i situatës në terren.

Shpesh herë flitet për goditje të bazave të prostitucionit, por shumë pak për fatin e mëtejshëm të atyre që kanë përfunduar në këtë rrjet, sidomos të grave dhe vajzave. Një numër artikujsh si, "Prostitucioni në qendër të Tiranës, bazë me klientë VIP", "Goditet baza e prostitucionit, 6 persona në pranga në Fier", "Seks me 20-50 mijë lekë, kapet vajza e klientët", "Lokali i fshatit në Lushnjë, bazë prostitucioni" nuk japin informacion të mëtejshëm se çfarë ndodh pas operacioneve të policisë: cili është fati i këtyre vajzave

dhe grave? Qëndrojnë në burg për akuzën e ushtrimit të prostitucionit? Rehabilitohen? Ndhimohen? Çfarë ndodh me familjet e tyre? Fëmijët e tyre? Këto janë tema të pa eksploruara, përgjigjet e të cilave mund të gjenden vetëm në ndjekjen e mëtejshme të rasteve të raportuara. Prandaj themi se raportimi i trafikimit të grave dhe vajzave mbetet i fragmentarizuar, i izoluar dhe i paplotë.


Nga ana tjetër, në çdo lajm për arrestimet për trafikim fshihet gjithmonë një apo disa gra të trafikuar, të cilat mund të kenë diçka për të treguar. Duke folur vetëm për arrestimet dhe të arrestuarit, kontribuojmë në "zhdukjen" e grave dhe vajzave të trafikuar, duke e bërë këtë një proces të njëanshëm, ndërkohë që publiku ka nevojë të dijë ç'është bërë me të mbijetuarat e trafikimit, nëse ato po ri-integrohen, si po integrohen, etj. Një dosje e bujshme si ajo e 16 vjeçares që denoncoi një rrjet trafikimi, "E mitura akuzon biznesmenin: Si u mashtrua gjimnazistja dhe kërcënimet për të mos ikur nga rrjeti" nuk mund të lihet në gjysmë të rrugës. Kjo flet për kanosje, frikë. Ç'është bërë me këtë vajzë? Si funksionon drejtësia për viktimat e trafikimit? Po me familjen e saj? Cili është mesazhi që i japim publikut? Të denoncojë apo të ketë frikë? Këto janë pyetje që mund t'u shërbejnë gazetarëve për ndjekur rastet e trafikimit, i cili siç e thamë ka disa etapa, por që fatkeqësisht raportohet sikur fillon dhe mbaron me policinë dhe veprimet e saj.

3.10 GAZETARËT

77.9% artikujve që lidhen me trafikimin, janë pa autor. Kjo situatë reflekton në njërën anë, mungesën e vëmendjes ose mosinteresimin nga ana e medias së shkruar për fenomenin e trafikimit, duke e pasqyruar atë vetëm në lajme shkurt me një paragraf të kopjuar nga buletinet e policisë - madje në një rast edhe

me një rresht - dhe nga ana tjetër, mungesën e njohurive të thelluara apo kuptimin e drejtë të trafikimit nga ana e gazetarëve. Megjithëse ka një numër më të madh vajzash (11.5%) që shkruajnë për trafikimin sesa djemtë (5.3%), kjo gjë nuk ndikon në cilësinë e artikujve, në kuptimin që nuk ka më shumë burime, analiza, apo përdorim të saktë të termave, varësisht nga gjinia e autorëve.


Grafiku nr. 13: Gjinia e gazetarëve që shkruajnë për trafikimin e grave dhe vajzave



Gazetarët që shkruajnë më shpesh për trafikimin janë gazetarët e kronikës, që mbulojnë policinë dhe gjykatat, të ndjekur nga korrespondentët e rretheve dhe më rrallë nga gazetarë të lajmeve sociale apo dhe kulturore. Vihet re se gazetarët që kanë shkruar më shumë se një herë mbi trafikimin kanë cilësi më të mirë raportimi se të tjerët

që shkruajnë rrallë, si p.sh., korrespondentët cilëve u kërkohet të mbulojnë të gjitha ngjarjet në një qytet, duke filluar nga kultura deri tek spitalet e sporti. Megjithatë, kur korrespondentët e ndjekin lajmin përtej ditës së ngjarjes, prodhojnë histori më të mira sesa gazetarët e kryeqytetit.

Grafiku nr. 14: Profili i gazetarëve që shkruajnë për trafikimin e grave dhe vajzave



Gazetarët e lajmeve sociale janë përfshirë në lajme për trafikimin kur ka pasur nisma që lidhen me mbështetjen e viktimave të trafikimit si p.sh., sigurimi i shpenzimeve shëndetësore, ndërsa gazetarët e lajmeve kulturore janë përfshirë kur ngjarje të tilla si, Festivali i Filmit për të drejtat e njeriut ka pasur në fokus dokumentarë me subjekt trafikimin e grave dhe vajzave. Në një rast tjetër, tema e trafikimit është pasqyruar përmes sensacionit të shkaktuar nga një intervistë me një aktor të njohur, të titulluar, “Si i kam njohur unë prostitutat”. Për fat të mirë, aktori ka bërë një dallim shumë të qartë midis atyre që shfrytëzohen dhe atyre që kanë zgjedhur të punojnë si punonjëse seksi, duke dhënë një informacion të vyer për lexuesit.

Duke qenë një dukuri shumë-dimensionale, trafikimi kërkon gazetarë të përgatitur jo vetëm të kronikës, por edhe të specialiteteve të tjera. Ndoshta ndarja e vjetër sipas rubrikave – lajme politike, sociale, kulturore, sportive, ekonomike – e gazetave shqiptare, nuk e ndihmon këtë shumë-dimensionalitet të shpërfaqet si duhet, ngaqë gazetarët janë të specializuar vetëm në një fushë. Përvoja e vendeve të tjera në riformulimin e rubrikave, e ndjekur në një masë të vogël edhe nga disa gazeta shqiptare, do të ndihmonte në profilizimin e gazetarëve sipas modelit profesional të përgjithshëm.

KAPITULLI 4

REKOMANDIME

Në bazë të gjetjeve të këtij monitorimi, i cili përfshiu 8 gazeta të përditshme për një periudhë 11 mujore, është e qartë se cilësia e raportimit rreth trafikimit është larg të qenit profesionale dhe e plotë. Këtu kontribuojnë një sërë faktorësh, duke nisur që nga gjendja financiare e gazetave, statusi i gazetarit, tregu mediatik, pavarësia editoriale dhe profesionalizmi i zyrave të shtypit. Rekomandimet e këtij monitorimi synojnë të ofrojnë disa alternativa konkrete dhe të realizueshme apo hapa që aktorët, dhe jo vetëm ata mediatikë, mund të ndërmarrin për përmirësimin e situatës:

1. Kur shkruajnë për trafikimin, sa herë që kanë vështirësi për përdorimin e termave apo mëdyshje në lidhje me informacionin e përcjellë, gazetarët duhet t'i referohen manualit për "Raportimin e rasteve të trafikimit dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri". Ky manual mund të gjendet në Zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Anti-trafikimin pranë Ministrisë së Brendshme.
2. Korrespondentët e rretheve duhet të përfshihen në trajnimet e ofruara nga aktorë të ndryshëm për raportimin e trafikimit, duke pasur parasysh prirjen e trafikimit të brendshëm. Kur është e mundur, trajnimet për raportimin e trafikimit duhet të kombinohen me trajnime për raportimin e diversitetit gjinor, barazisë gjinore, etj.
3. Duhet të gjendet mënyra e përfshirjes së redaktorëve dhe sidomos kryeredaktorëve në trajnimet mbi trafikimin, duke qenë se janë ata që vendosin për titujt dhe lajmet e faqes së parë.

4. Gazetarët duhet të përdorin sa më shumë burime, minimalisht më shumë se një, duke zgjeruar bashkëpunimin me organizatat që mbrojnë të drejtat e njeriut, sidomos me ato të grave, me ekspertë vendas dhe të huaj. Zërat e viktimave të trafikimit dhe të familjarëve të tyre duhet të zënë më shumë vend në historitë për trafikimin.
5. Organizatat për mbrojtjen e të drejtave të grave duhet të jenë më aktive dhe të bashkëpunojnë me gazetarët, për të vënë në dukje shkaqet, nismat dhe sidomos rehabilitimin e viktimave të trafikimit.
6. Organizatat që ofrojnë shërbime për të mbijetuarat nga trafikimi duhet të ofrojnë informacion për portokollet apo procedurat që duhet të ndjekë një gazetar për të marrë më shumë informacion, por edhe gazetarët nga ana e tyre duhet të interesohen për t'i njohur dhe respektuar këto procedura, të cilat bëhen shpesh hendeq mes dy palëve.
7. Kur shkruajnë për trafikimin, gazetarët duhet të shkojnë përtej shtresës së parë të raportimit dhe t'i përgjigjen pyetjes “pse”. Gazetarët duhet të ofrojnë më shumë analiza dhe kontekst, duke iu referuar kuadrit ligjor dhe përpjekjeve për ri-integrim, pa dëmtuar privatësinë e të mbijetuarave nga trafikimi.
8. Së pari, zyrat e shtypit në polici dhe pastaj gazetarët duhet të tregojnë kujdes në përdorimin e saktë të termave apo të akuzave që lidhen me veprën penale të trafikimit, si dhe të ofrojnë mbrojtje më të madhe për të dhënat personale të viktimave.
9. Përdorimi i fotove në artikujt për trafikimin e grave dhe vajzave duhet të bëhet në përputhje me brendinë e lajmit. Kur është e mundur, organet e drejtësisë duhet të ndihmojnë gazetarët me foto të të arrestuarve/dënuarve për trafikim, sepse në mungesë të tyre, gazetarët do të përdorin foto ilustruese që ekspozojnë vajzat e shfrytëzuara. Në mungesë të fotove, përdorimi i grafikëve është

gjithashtu një alternativë shumë e mirë, për të shoqëruar shkrimet për trafikimin.

- 10.** Ndjekja në vijimësi e rasteve të trafikimit është e rëndësishme, për të treguar që trafikimi është një tmerr që ka një fund dhe që trafikantët dënohen.
- 11.** Gazetarët nuk duhet të përdorin asnjëherë fjalën “prostitutë” në shkrimet që kanë lidhje me trafikimin. Gjithmonë duhet bërë dallimi midis viktimave të trafikimit dhe punonjëseve të seksit. Formulimi i fjalive duhet të tregojë qartë se vajzat janë shfrytëzuar. Etiketimet e padenja dhe fyese ndihmojnë në stigmatizimin e mëtejshëm të viktimave, duke ua vështirësuar ri-integrimin në shoqëri. Gjithashtu, titujt duhet të nxjerrin në pah problemin dhe jo sensacionin.
- 12.** Historitë e riintegrimit të viktimave të trafikimit duhet të zënë më shumë vend në faqet e gazetave.
- 13.** Duhet parë mundësia për një kurs në programin Master të gazetarisë për raportimin e trafikimit sipas shembullit maqedonas, për një kuptim më të gjerë të trafikimit nga gazetarët, dhe jo vetëm të kronikës.
- 14.** Duhet të ndërmerret një studim për të kuptuar arsyet e raportimit të pamjaftueshëm dhe të pasaktë rreth trafikimit në shtypin shqiptar.

SHTOJCA 1.

KRITERET DHE TREGUESIT E PËRDORUR NË MONITORIM

KRITERET	TREGUESIT																
Shpeshtësia e përgjithshme	<ul style="list-style-type: none"> a. Numri i artikujve për trafikimin e grave dhe vajzave b. Nr. i faqes c. Rubrika d. Zhanri 																
Shpeshtësia e artikujve per TVG sipas muajve	Nr i artikujve sipas muajve: <table border="1"> <tr> <td></td> <td>Shkurt</td> <td>Mars</td> <td>Prill</td> </tr> <tr> <td>Maj</td> <td>Qershor</td> <td>Korrik</td> <td>Gusht</td> </tr> <tr> <td>Shtator</td> <td>Tetor</td> <td>Nëntor</td> <td>Dhjetor</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </table>		Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor				
	Shkurt	Mars	Prill														
Maj	Qershor	Korrik	Gusht														
Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor														
Fokusi i artikullit	<ul style="list-style-type: none"> 1. Viktima 2. Trafikanti/ët 3. Analiza e shkaqeve/pasojave 4. Të tjera 																
Mbulimi gjeografik i fenomenit (ne nivel qarqesh)	<ul style="list-style-type: none"> 1. Tirana 2. 12 Qarqet 																

KRITERET	TREGUESIT
Burimi i informacionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i burimeve <ol style="list-style-type: none"> a. Një burim b. Më shumë se një burim 2. Natyra e burimeve <ol style="list-style-type: none"> a. Policia b. Shërbimet sociale c. Organizatat d. Strehët e. Ministria e Brendshme f. Gjykata g. Prokuroria h. Të mbijetuarat
Qasja Raportimi pozitiv Raportimi negativ Raportimi neutral	<ol style="list-style-type: none"> 1. Konteksti 2. Analiza shkak-pasojë 3. Ndjekja e rastit 4. Gjuha e përdorur
Llojet e trafikimit	Trafikimi i brendshëm/Trafikimi i jashtëm Trafikimi i të rriturve/Trafikimi i të miturve
Mënyrat e shfrytëzimit të viktimave të dhunës	Prostitucion Punë e detyruar Lypje
Terminologjia/gjuha e përdorur	Etiketimet e : <ol style="list-style-type: none"> 1. Viktimave 2. Trafikimit

KRITERET	TREGUESIT
Privatësia dhe ruajtja e të dhënave personale	Nr. i artikujve ku përmendet: <ol style="list-style-type: none"> 1. Emri/mbiemri i viktimës 2. Emri/mbiemri i familjarëve të viktimës 3. Emri/mbiemri i punonjësve të policisë 4. Emri/mbiemri i punonjësve social 5. Vendbanimi i viktimës 6. Moshë e viktimës 7. Detaje të tjera
Mbulimi grafik/ilustrues i artikujve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Foto 2. Grafikë
Lloji i artikullit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Informativ 2. Ndërgjegjësues 3. Analitik
Autorët e artikujve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gjinia <ol style="list-style-type: none"> a. Mashkull b. Femër 2. Specialiteti <ol style="list-style-type: none"> a. Kronikë e zezë b. Sociale c. Korrespondent d. Kulturë e. Tjetër 3. Shpeshtësia <ol style="list-style-type: none"> a. I njëjti autor b. Autorë të ndryshëm
Qasja	<ol style="list-style-type: none"> 1. Artikuj të lidhur drejtpërdrejt me trafikimin 2. Artikuj ku trafikimi nuk del si temë qendrore